

VENDIM
Nr.10,datë 25.1.2008

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE SHOQËRISË “OSSH” SHA**

Në zbatim të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa c, nenit 14, pika 1, si dhe nenit 15, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.862, datë 20.12.2006 “Për krijimin e shoqërisë “OSSH” sh.a. dhe nenit 10, pika 1, nenit 16, germa a dhe nenit 19, pika 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 4.4.2007, “Rregullores për procedurat e licencimit”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “OSSH” sh.a. për marrje licence për aktivitetin e importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Dhënie e licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike shoqërisë “OSSH” sh.a. për periudhën nga 25.1.2008, deri më 25.1.2011.
2. Kjo licencë jepet me kushtin që:
 - a) Shoqëria “OSSH” sh.a., brenda datës 31.12.2008, të bëjë sigurimin e aktivitetit të importit të energjisë elektrike në përputhje me “Rregullat për procedurat e licencimit”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta